



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 769/ Prot. 2

Tiranë, më 20/09/2023

VENDIM

Nr. 35, DATË 20/09/2023

PËR

**“DHËNIEN E TITULLIT “DOKTOR HONORIS CAUSA”  
Z. GIULIO RAPETTI MOGOL”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 (Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë), neni 38 (Funksionet e Senatit Akademik), të VKM Nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, Kreu i V-të (Dispozita të fundit dhe kalimtare), pika 1, të Statutit të UART, neni 24, pika 1, gërma ff, si dhe në propozimin e Fakultetit të Muzikës bashkëngjitur, Senati Akademik i Universitetit të Arteve,

V E N D O S I:

1. Të japë titullin “Doktor Honoris Causa” për *Z. Giulio Rapetti Mogol*, me motivacionin:

**Tekstshkrues dhe producent diskografik i shquar italian, me kontribut të pashlyeshëm në industrinë e muzikës, duke prodhuar klasikë të përjetshëm që jo vetëm janë bërë pjesë e strukturës kulturore të Italisë por kanë kapërcyer edhe kufijtë e gjuhët, si një burim i qëndrueshëm frymëzimi për artistë të panumërt dhe brezat e rinj.**

2. Të caktojë reçentë Prof. Arben Llozi dhe Prof. Asoc. Merita Rexha Tërshana.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI

Prof. Asoc. Genci FUGA

Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)

